



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:137440
Datë: 20.11.2024
Numri i dokumentit: 06490207

C.nr.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Haxhi Xhemajli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, rr. Lidhja e Pejës, p.n., të cilën e përfaqëson e autorizuar Mahije Maloku, kundër të paditurit, Sh.R nga K.P. me objekt kontesti: rimbursim i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit: 3,365.00 euro, në prezencën e të autorizuarës së palës paditëse dhe në mungesë të të paditurit, në seancën e shqyrtimit kryesor, me datë 11.11.2024 mori, ndërsa përpiloi me datë 20.11.2024, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses: Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, Rr. Lidhja e Pejës, pa nr., dhe DETYROHET i padituri Sh.R nga K.P, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material për aksidentin e datës ..., t'i paguaj shumën në lartësi prej: 3,365.00 euro, me kamat ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë me datë ..., e deri në pagesën e plotë, të gjitha këto t'i përmbush në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmburimit të detyrueshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, Byroja Kosovare e Sigurimeve, në këtë gjykatë ka parashtruar padi me datë ..., me objekt kontesti, rimbursim i demit material dhe jo material, dhe me vlerë të kontestit 3,365.00 Euro.

Paditësja nëpërmes të autorizuarës së saj, me padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke kërkuar që të DETYROHET i padituri për rimbursimin e dëmit material dhe jo material, nga baza e auto përgjegjësisë për aksidentin e ndodhur me datë ..., me arsyetimin se me provat e administruara është vërtetuar në tërësi baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë së paditëses, duke kërkuar nga

gjykata që kërkesëpadia e paditëses të APROVOHET në tërësi si e bazuar, si dhe të detyrohet i padituri në pagimin e shpenzimeve e procedurës.

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike kontestimore është mbajtur në mungesë të të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, dhe i cili mungesën nuk e ka arsyetuar. Prandaj, gjykata duke marr për bazë nenin 423 paragrafi 4 të LPK, si dhe pas propozimit të autorizuarës se palës paditëse, vendosi që shqyrtimi kryesor të mbahet në mungesë të palës së paditur.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Transferi nga kontoja numër ... i datës ...; ujdia jashtëgjyqësore e datës ...; raporti i aksidentit me numër ... i datës ...; procesverbali mbi shiqimin e aksidentit i datës ...; transferi nga kontoja numër ... e datës ...; ujdia jashtëgjyqësore e datës ...; aktvendimi mbi trashëgimin e datës ...; transferi nga kontoja numër ... e datës ...; ujdia jashtëgjyqësore e datës ...; policia e sigurimit me numër ... e datës ...; ekspertiza nga lëmia e komunikacionit e datës ...; dosja e dëmit jo material për familjen L.; dosja e dëmit material për M.L; dosja e dëmit material për Xh.B.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (këtu e tutje: LPK), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsye se:

Nga provat e administruara gjykata ka konstatuar se, me datën ..., në orën ... minuta në Pejë, ka ndodhur aksident trafiku ku pjesëmarrës në këtë aksident ishte vetura e tipit Opel Corsa, me ngjyrë të kaltër, të cilën në momentin e aksidentit e drejtonte Sh.R nga K.P, dhe vetura e tipit Fiat Punto, me ngjyrë të kaltër me targa ..., të cilën në momentin e aksidentit e drejtonte M.L nga Peja. Ky aksident është shkaktuar me fajin e drejtuesit të automjetit Opel Corsa, këtu të paditurit, automjetin të cilin e drejtonte i padituri në momentin e aksidentit nuk kishte sigurim dhe regjistrim. Gjithashtu, si pasojë e këtij aksidenti përveç dëmeve materiale në automjetet pjesëmarrës, shkaktohen edhe lëndime trupore, me ç'rast lëndime trupore pëson M.L - drejtuesi i automjetit Fiat Punto, dhe djali i tij T.L.

Në bazë të Ujdisë Jashtëgjyqësore më nr. ... e datës ..., gjykata konstaton se i dëmtuari në këtë aksident - pronari i automjetit Fiat Punto M.L (Familja L.), ka lidhur marrëveshje me Byroja Kosovare e Sigurimit – këtu tani paditësen, për kompensimin e dëmit jo material për lëndimet trupore në shumën e tërësishme prej 1575.00 euro.

Në bazë të Transferit nga kontoja me numër ..., të datës ..., gjykata provoj faktin se Byroja Kosovare e Sigurimit, ka bërë pagesën e detyrimit sipas Ujdisë Jashtëgjyqësore të lartë cekur në llogari bankare të dëmtuarit (familja L.) në këtë aksident.

Në bazë të Ujdisë Jashtëgjyqësore më nr. ... e datës ..., gjykata provoj faktin se i dëmtuari në këtë aksident - pronari i pronës së dëmtuar Xh.B., ka lidhur marrëveshje me Byroja Kosovare

e Sigurimit për kompensimin e dëmit të shkaktuar në pronë në shumën e tërësishme prej 225.00 euro.

Në bazë të Transferit nga kontoja numër ... të datës ..., gjykata provoj faktin se Byroja Kosovare e Sigurimit, ka bërë pagesën e detyrimit sipas Ujdisë Jashtëgjyqësore me nr. ... e datës ..., në llogari bankare të pronarit të pronës se dëmtuar në këtë aksident.

Në bazë të Ujdisë Jashtëgjyqësore me nr. ... e datës ..., gjykata provoj faktin se i dëmtuari në këtë aksident M.L., ka lidhur marrëveshje me Byroja Kosovare e Sigurimit për kompensimin e dëmit material në shumën e tërësishme prej 1565.00 euro.

Në bazë të Transferit nga kontoja numër ... të datës ..., gjykata provoj faktin se Byroja Kosovare e Sigurimit, ka bërë pagesën e detyrimit sipas Ujdisë Jashtëgjyqësore me nr. ... e datës ..., në llogari bankare të të dëmtuarit në këtë aksident.

Në bazë të Raportit të aksidentit me numër ... i datës ..., gjykata provoj faktin e ndodhjes se aksidentit me datë ... në ora

Në bazë të procesverbalit mbi vendshikimin e aksidentit me nr..., i datës ..., të Njësitit të Hetimeve të Aksidenteve – Drejtoria Rajonale e Policisë Pejë, gjykata konstaton kohën, vendin dhe pjesëmarrësit e aksidentit.

Gjykata, në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 07.11.2023, me qëllim të vërtetimit të bazës juridike të padisë, ka caktuar zyrtarisht marrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmia e komunikacionit, dhe me aktvendiminc.nr. 112/19, të datës 11.03.2024, ka caktuar ekspertin Nexhat Avdijaj nga lista e KGJK. Me ekspertizën e tij të përpiluar me shkrim të datës 20.03.2024, kishte konstatuar se, *“Drejtuesi i automjetit “A” Opel Corsa bënë lëvizje mbrapa me automjet në mënyrë të pa kujdesshme dhe të pa kontrolluar, duke i rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacionin rrugor. Prandaj lëshimet e lartshënuara nga ana e drejtuesit të automjetit “A” kanë qenë shkak për të ardhur deri të aksidenti i trafikut.”* Gjykata ekspertizën e ekspertit të komunikacionit e mori në tërësi të besueshme dhe relevante, për faktin se e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për rimbursimin e dëmit ndaj paditëses gjënë mbështetje në Ligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (këtu e tutje: LSDA), përkatësisht neni 14 paragrafi 3, lidhur me nenin 245 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (këtu e tutje: LMD).

Gjykata në këtë rast vlerëson se, në njërën anë e drejta e të dëmtuarve për të kërkuar shpërblimin e dëmit si rezultat i aksidentit të datës ..., gjënë mbështetje në paragrafin 1 të nenit 18 të LSDA, i cili përcakton se, *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësia, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja.”* Ndërsa në anën tjetër, meqenëse paditësja në bazë të provave të bashkëngjitura në shkresat e

lëndës e ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarve që kanë pësuar nga ky aksident, të njëjtës i njihet e drejta që të kërkoj rimbursimin e shumës së paguar, konform nenit 14 paragrafi 3 të LSDA i cili përcakton se, “*Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese,*” si dhe lidhur me paragrafin 3 të nenit 18 të të njëjtit ligj, i cili parasheh se, “*Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.*”

Për me tepër, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 të LPK, palët kanë për detyrë t’i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas nenit 319 paragrafi 1 të LPK, parashihet se secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t’i provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Në këtë rast, meqenëse i padituri me asnjë provë të vetme nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, gjykata e vënë para një situatë të tillë, dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik – civil i të paditurit ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit, në shumën prej 3,365.00 euro. Një përfundim të tillë, gjykata e mbështeti në normën nenit 245 paragraf 1 të LMD, i cili shprehimisht parasheh se, “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*” Pra, si rezultat i veprimeve të të paditurit, paditësja e ka paguar në tërësi dëmin e ka shkaktuar nga i padituri, dhe në këtë rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësja e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Sa i përket vendimit lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në normën e nenit 382 të LMD, dhe paragrafit X (dhjetë) të Mendimit Juridik për Kamatën nr. 265/2020 të datës 01.12.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke ju referuar datës së parashtrimit të padisë, përkatësisht datës

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në harmoni me nenin 463 paragrafi 1 të LPK i cili përcakton se, “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën.*” Në këtë rast, pala paditëse nuk ka parashtruar kërkesë të specifikuar për shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës, e që një detyrim të tillë e ka edhe në bazë të paragrafit 2 të të njëjtit nen, i cili parasheh se, “*Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës.*” Pra, e autorizuara e paditëses gjatë shqyrtimit kryesor nuk i ka dorëzuar gjykatës një listë të specifikuar të shpenzimeve, prandaj gjykata konform nenit 450 të LPK, vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në nenin 14 paragrafi 3, 18 paragrafi 1 dhe 3 të LSDA, nenit 245 paragrafi 1 të LMD, si dhe në harmoni me nenin 143 paragrafi 1, 450 dhe 463 paragrafi 1 dhe 2 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:137440
Datë: 21.11.2024
Numri i dokumentit: 06490207

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:137440; C.nr.; datë 11.11.2024

Gjyqtari

Haxhi Xhemajli

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.